



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 3462 prot

Tiranë, më 02.07.2020

**URDHËR**

Nr 77 Datë 02.07.20

**“PËR PROCEDURËN E DORËZIMIT / PRANIMIT TË DOKUMENTAVE DHE RAPORTEVE TË VETMONITORIMIT”**

Në bazë të ligjit Nr. 53/2020 për një ndryshim në ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” të ndryshuar, të ligjit Nr. 52/2020, për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar, VKM Nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

**URDHËROJ:**

1. Të gjitha dokumentat dhe raportet e vetmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të tipit A dhe B, të dorëzohen dhe protokollohen në protokollin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me shkresë përcjellëse mbi dokumentacionin e paraqitur sipas pikës 3, në formatin CD.
2. Drejtorinë e Inspektim - Kontrollit, Sektorin e Monitorimit të kontrollojë, verifikojë dokumentacionin dhe raportet e vetmonitorimit, si dhe përditesojë regjistrin e dokumentave / raporteve të vetmonitorimit sipas formatit të miratuar, që dorëzohen pranë AKM-së nga operatorë të pajisur me leje mjedisi tipi A dhe B.
3. Lista e dokumentacionit që dorëzohet nga operatorët e pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B, është sipas aneksi 1, bashkangjitur këtij urdhëri.
4. Afati i dorëzimit të dokumentacioneve dhe raporteve të vetmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore tipi A dhe B, është:
  - 4.1 Dorëzimi i raporteve të vetmonitorimit për instalimet e tipit A dhe B, deri më datë 31.07.2020 do të kryhet sipas Urdhërit Nr.152, datë 10.09.2018 të “Për

procedurën e dorëzimit / pranimit të raporteve të vetmonitorimit”. Duke filluar nga data 01.08.2020 operatorët e instalimeve ekzistuese të tipit A dhe B, duhet të dorëzojnë dokumentacionet dhe raportet e vetmonitorimit brenda 15 ditëve kalendarike nga data e miratuar në Tabelën 12.1.1 të lejes mjedisore tipi B dhe në Tabelën 6.1.1 të lejes mjedisore tipi A.

ANË  
MBËTARË E MJEDISIT

5. Të kërkohet plotësim dokumentacioni apo informacion shtesë në rastet kur operatorët tipit A ose B, nuk kanë zbatuar kushtet e lejes së mjedisit të tipit A dhe B në dokumentacionin dhe raportin e vetmonitorimit të dorëzuar në protokollin e AKM-së.
6. Mbas datës 01.08.2020 nuk do të paranohet asnjë dokumentacion dhe raport vetmonitorimi i cili nuk është në përputhje me kërkesat e këtij urdhëri.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**EDISON KONOMI**



## ANEKSI 1

ZBATIMI I KUSHTEVE QE PLOTESOHEN VETEM 1 HERE (3 mujori I pare I lejes)		
Nr	Emertimi i Dokumentit	Kushti i lejes mjedisore
1	Masat e ndermarra perpara vendosjes ne funksionim te instalimit	1.5
2	Plani I menaxhimit te mbetjeve	1.5
3	Operimi dhe Infrastruktura	3
4	Programi i Menaxhimit te Riskut	3.4.8
5	Dokumenti I vleresimit te Riskut	3.4.8
6	Plani i perputhshmerise	4
7	Interpretimi i vlerave te shkarkimeve	5
8	Dokumentimi dhe Raportimi	12
9	Regjistri i shkarkimit te ndotjes	12
10	Programi i Monitorimit te Zhurmes	12
11	Programi i Menaxhimit te Mjedisit	12
12	Plani i veprimit per veprimtarite minerare me karriere (guroret)	12 kur kerkohet
13	Incidentet dhe veprimet gjate emergjencave	13
14	Politika dhe plani i parandalimit te akisenteve	13
15	Cmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas nderprerjes se operacioneve	14
16	Plani I rehabilitimit te objektit minerar	14 kur kerkohet

Zbatimi I kushteve periodike 3 ose 6 mujore		
Nr	Emertimi i Dokumentit	Kushti i lejes mjedisore
1	Vendndodhja e ushtrimit te veprimtarise	1.6
2	Njoftimet	6
3	Shkarkimet	7
4	Plani i Menaxhimit te Tretesave Organik	7
5	Inspektime Vizuale Ditore/Javore/Mujore per instalimet dhe shkarkimet ne ajer, uje, toke, zhurme, mbetje	7
6	Mirembajtja/Plani i Sherbimeve	7
7	Menaxhimi i Mbetjeve	8
8	Plani i Menaxhimit te Mbetjeve	8
9	Zhurmat dhe Vibracionet	9
10	Monitorimi	11
11	Dokumentimi dhe Raportimi	12
12	RAPORTI PERIODIK I MONITORIMIT	12

ZBATIMI I KUSHTEVE VJETORE		
Nr	Emertimi i Dokumentit	Kushti i lejes mjedisore
1	Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e perberesve te mjedisit per instalimin/impiantin	2
2	Programi i Menaxhimit te Mjedisit	2.9.2

## ANEKSI 1

3	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes - Raport per vitin paraardhes	2.9.2
4	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotjes - Propozim per vitin aktual ushtrimor	2.9.2
	Raport permbledhes mbi rezultatet per monitorimin e zhurmes	2.9.2
5	Pershkrimi i Monitorimit te Mjedisit	2.9.2
6	Pershkrimi i Incidenteve/Aksidenteve	2.9.2
7	Raport permbledhes per Auditimin e Eficiences se Energjise	2.9.2
8	Raport per vleresimin e eficiences se shfrytezimit te lendeve te para dhe reduktimin e gjenerimit te mbetjeve	2.9.2
9	Menaxhimi i Mbetjeve	2.9.2
10	Raport permbledhes per Auditimin e Eficiences se Ujit	2.9.2
11	Deklarate mbi masat per parandalimin e ndotjes se mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit	2.9.2
12	Programi i Menaxhimit te Riskut	2.9.2
13	Plani i perputhshmerise	2.9.2
14	Plani i cmontimit ose rehabilitimit	2.9.2
15	Lendet e para dhe shfrytezimi i energjise	10
16	Dokumentimi dhe Raportimi	12
17	Raport mbi ankesat	
18	Incidentet dhe veprimet gjate emergjencave	13
19	Cmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas nderprerjes se operacioneve	14
20	RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT	